VENDIM
Nr.488, datë 6.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.17, DATË 21.1.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDEVE PUBLIKE, PËR VEPRIMTARI SPECIFIKE, OPERATIVE, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ të Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.17, datë 21.1.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Shërbimi Informativ i Shtetit, për realizimin e detyrave, të përdorë fondin specifik, operativ, si dhe fonde të tjera, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që i vihen në dispozicion për këtë qëllim.

Ky fond të përdoret për:

a) Shpërblimin e burimeve të informacionit;

b) Shpenzimet për sigurimin e informacionit;

c) Veprimtarinë e strukturave të fshehta;

ç) Blerje me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, të punëve, mallrave, shërbimeve, në funksion të veprimtarive operative për:

i) pajisje dhe programe, që shërbejnë për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

ii) sisteme, aparatura dhe pajisje teknike profesionale;

iii) mjete motorike.

d) Marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve, në funksion të veprimtarive operative.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha